



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 4, datë 29.10.2015

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: "RESTAURIMI I  
GODINËS SË PREFEKTURËS SË QARKUT TIRANË"

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, nenit 15 dhe 19 të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", e ndryshuar dhe Vendimit Nr. 877, datë 03.10.2013 të Këshillit të Ministrave "Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit", me propozimin e Prefektit të Qarkut Tiranë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: "Restaurimi i Godinës së Prefekturës së Qarkut Tiranë", me subjekt kërkues Prefektin e Qarkut Tiranë.
2. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas plotësimit të dokumentacionit ligjor dhe teknik.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Prefekti i Qarkut Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



**ZËVENDËS KRYETARE E KKT**

**EGLANTINA GJERMENI**

**MINISTER I ZHVILLIMIT URBAN**



**SEKRETARE E KKT**

**LEDIA TOTA**

**DREJTORE E AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

